

RREGULLORE E SHKOLLËS DHE E OBJEKTIT

për nxënësit e shkollës fillore në Brig-Glis, Gamsen, Brigerbad

(krahaso www.brigga.ch)

1. Mirësjellja

- Nxënësit, personeli mësimdhënës, punonjësit, drejtorja e shkollës takohen gjithnjë me sjellje miqësore dhe të kujdesshme ndaj njëri-tjetrit.

2. Rruga për në shkollë

- Mbikëqyrja dhe përgjegjësia gjatë rrugës për në shkollë është çështje e prindërve.
- Në rrugën e shkollës, nxënësve nuk ju lejohet përdorimi i biçikletës apo i skuterit (makina të ngjashme me automjetet). Megjithatë, drejtori i rrethit të shkollës, mund të lëshojë miratime të veçanta, po qe se paraqiten kërkesa të bazuara.

3. Mjedi i shkollës

- Në raste të ndërprerjes së mësimëve, nuk lejohet qëndrimi në mjedisin e shkollës.

4. Para shkollës

- Nxënësit, që në mëngjes futen më herët në godinën e shkollës, duhet të qëndrojnë në klasë, bashkë me mësuesit.

5. Në godinën e shkollës / në shkallë / në dhomat e shkollës

- Nuk vrapoj, nuk bërtas, nuk kacafytem dhe nuk shtyej asnjëri.
- Nuk luaj dhe nuk hedh me topa.
- Gjatë kohës së mësimëve, sillem i qetë në godinën e shkollës.
- Kujdesem që të ketë rregull në garderobë (këpucët, xhaketat, çantat për rrobat sportive, etj.).
- Këpucët, xhaketat, çantat për rrobat sportive, duhet të vendosen në garderobë.
- Gjatë mësimit nuk mbaj kapuçë apo mbulime të tjera mbi kokë.
- Nuk lejohet mbajtja në gojë e çamçakizëve në dhomat e shkollës.
- Orenditë e shkollës i trajtoj me kujdesin e duhur. Po qe se e shkaktoj ndonjë dëm, atëherë duhet të paraqis rastin tek mësuesit dhe tek kujdestari i shkollës. Dëmtimet, të cilat i kam shkaktuar me paramendim, duhet të paguhen nga unë gjegjësisht nga prindërit e mi.

6. Pushimi dhe vendi i pushimit

- Gjatë kohës së pushimit nuk qëndroj brenda godinës së shkollës.
- Në WC (nevojtoje) shkoj vetëm kur fillon koha e pushimit.
- E shfrytëzoj hapësirën e pushimit, e cila është caktuar për klasën time.
- Nuk e braktis vendin e pushimit.
- I respektoj udhëzimet e mbikëqyrësve të pushimit.
- Lojërat me top lejohen vetëm në fushat e caktuara të aktiviteteve.
- Lojërat me top të zhvillohen vetëm me topa të butë. Kur kemi mot me shi, nuk lejohen lojërat me top.
- Mbeturinat i hedh në shportën e mbeturinave.
- Në qoftë se dikush më ngacmon, atëherë e kërkoj dialogun ose i drejtohem mbikëqyrësve të pushimit.
- I largohem çfarë do forme të dhunës.
- Mbarimi i pushimit: Me rënien e këmbanës së pushimit, i bashkëngjitem klasës sime në vendin e caktuar.

7. Pirja e duhanit

- Në të gjithë ambientin e shkollës (godina e shkollës, vendi i pushimit etj.) nuk lejohet pirja e duhanit.

8. Telefonat celularë, aparatet teknike (MP3, radio, etj.)

- Përdorimi i telefonave celularë apo i aparateve elektronike është i ndaluar gjatë të gjithë kohës në shkollë.
- Aparatet duhet t'i lëni të fikur në çantë.
- Në rast të mosrespektimit të dy rregullave të para, aparati duhet t'i jepet mësimdhënësit. Rikthimi bëhet përsëri në fund të mësimi.
- Në qoftë se mosrespektimi ndodhë në mënyrë të përsëritur, bëhet lajmërimi tek prindërit.
- Në raste të shkeljeve të rënda, bëhet kallëzimi penal.

9. Mungesat dhe terminet

- Në qoftë se nuk do të mund të ndjek mësimet për arsyeshme shëndetësore, atëherë prindërit e mi e bëjnë paraqitjen telefonike - para fillimit të mësimi - tek mësimdhënësjë kujdestare apo tek sekretariati i shkollës (027/922 42 30)
- Vizitat tek mjekët apo tek dentistët duhet të vërtetohen nga ana e mjekut apo nga prindërit e mi, duke e dorëzuar këtë vërtetim të paktën një ditë më përpara tek mësimdhënësit përkatës.

10. Aktivitetet shkollore

- Shëtitjet (ekskurzionet) apo rastet e tjera, të organizuara nga shkolla, janë të detyrueshme për mua.

11. Hedhja me topa dëbore

- „Hedhja me topa dëbore“ është e ndaluar në të gjithë ambientin e shkollës dhe të pushimit.

12. Masat e dënimit

Po qe se nuk i përmbahem udhëzimeve të caktuara, më duhet t'i mbajë pasojat.

Këto janë masat e parashikuara:

12.1. Nga ana e mësimdhënësjë

12.1.1. Punë shtesë

Po qe se nuk i përmbahem detyrimeve të mia, mësimdhënësi mund të më detyrojë me punë shtesë prej tri orësh.

12.1.2. Qëndrimi më gjatë pas mësimi, me mbikëqyrje

Qëndrimi më gjatë pas mësimi, me mbikëqyrje, mund të zgjasë më së shumti dy orë. Po qe se qëndrimi më gjatë pas mësimi ka për të zgjatur më tepër se tridhjetë minuta, informohen paraprakisht prindërit e mi.

12.2. Nga ana e drejtorisë së shkollës

Drejtoresha e shkollës ka të drejtë të shqiptojë paralajmërime të rrepta ose të vendosë për kalimin e nxënësit në një klasë / shkollë tjetër. Për një gjë të tillë, prindërit informohen paraprakisht.

12.2.1. Paralajmërimet

Drejtorja e shkollës më shqipton një dënim:

- në bazë të kërkesës së mësimdhënësit, pasi më është tërhequr vëmendja disa herë gjegjësisht pasi të jem kritikuar fortë.
- nëse kam shkelur në mënyrë të rëndë udhëzimet e rregullores së shkollës dhe të objektit.

12.2.2. Masa e kalimit në një klasë / shkollë tjetër

Në qoftë se bëhet e nevojshme një gjë e tillë, unë mund të kalohem në një klasë apo në një shkollë tjetër, por duke i mbajtur në rezervë edhe masat e tjera.

13. Sanksionim e njësisihëm

Në mënyrë që të trajtohen të gjithë nxënësit njëjtë, është i vlefshëm katalogu i masave ndëshkuese, me sa vijon:

<ul style="list-style-type: none">Mungesa e paarsyetuar nga mësimi:	<ul style="list-style-type: none">Përsëritja e dyfishtë e kohës së mësimit në objektin e shkollës.Lajmërim i prindërve dhe i drejtoreshës së shkollës nga ana e mësimitdhënësit.
<ul style="list-style-type: none">Shkelje ndaj ndalimit për duhanin:	<ul style="list-style-type: none">2 orë punë shtesë në objektin e shkollësLajmërim i prindërve dhe i drejtoreshës së shkollës nga ana e mësimitdhënësit.
<ul style="list-style-type: none">Shkelje ndaj rregullit 8 (aparate elektr.):	<ul style="list-style-type: none">1 orë punë shtesë në objektin e shkollës.
<ul style="list-style-type: none">Largimi i palejuar nga vendi i pusimit:	<ul style="list-style-type: none">1 orë punë shtesë në objektin e shkollës.Lajmërim i prindërve dhe i drejtoreshës së shkollës nga ana e mësimitdhënësit.

Dënimet e përmendura më sipër shqiptohen dhe kontrollohen nga mësimitdhënësit.

14. Të drejta ankese

Personi i kontaktit në lidhje me ankesat është mësimitdhënësi im.

15. Raste të veçanta / rregullat e përjashtimit

Rastet e veçanta dhe rregullat e përjashtimit i takojnë drejtorisë së shkollës.

Brig-Glis, Juli 2008

Drejtoresha e shkollës